



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 262, Datë 02.12.2024

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SLR ALBANIA” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a” , 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2152/7prot., datë 27.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2152 prot., datë 16.10.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 228, datë 28.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 29.10.2024 dhe 30.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 07.11.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2340 prot., datë 04.11.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 2152/3 prot., datë 08.11.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar për këtë aplikim dhe i kujtoi shoqërisë plotësimin e këtij dokumentacioni me e-mailin e datës 19.11.2024, protokolluar në ERE me nr. 2152/4 prot.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2152/5 prot., datë 27.11.2024 dhe nr. 2152/6 prot., datë 27.11.2024.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.01.2024 *“Për ndërtimin, shfrytëzimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grukë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqërisë “SLR ALBANIA” sh.p.k.”*.
 - Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. me nr. 5972/3 prot., datë 27.07.2022.
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 28.07.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin *“Ndërtim i impiantit fotovoltaike 2 MW, Topojë, Fier”*, për shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. Referuar afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je, shoqëria duhet të fillonte punimet për ndërtimin e centralit brenda datës 28.07.2024. Shoqëria ka bërë me dije ka aplikuar për pajisje me VNM të re në datën 01.10.2024 dhe është në pritje të miratimit të saj. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitohet në ERE, VNM Paraprake të re përpara fillimit të operimit.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka plotësuar jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaike për 49 vjet, duke iu referuar afateve të kontratës me MIE-n. Por në planin e biznesit të saj rezulton se jetëgjatësia ekonomike e centralit do të jetë 25 vjet, ndaj në këto rrethana, vlerësojmë që afati i licencës të jetë për 25 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të Kontratës nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.01.2024, të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë centralin brenda 12 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto rrethana vlerësohet që në vendimin e licencimit të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kësaj kontrate.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovotlaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria “SLR ALBANIA” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në Paraprake të re.
3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në zbatim të plotësimit të pikave 2 dhe 3.
5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SLR ALBANIA” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI